| | | | | <p>Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ju sqarojmë se takimi juaj është realizuar në datën 02 Korrik 2021, me punonjësit e Sektorit të Ndhmës Juridike dhe Ankesave pas kërkesës suaj të mëparshme nëpërmjet komunikimit telefonik, të cilët ju kanë informuar se ankesat tuaja me nr. 3093 prot., datë 06.07.2021 dhe nr. 3599 prot., datë 15.09.2021, janë aktualisht në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për çdo vendim që do të marrë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ju do të njoftoheni sipas ligjit.</p> | | |
|--|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|---|------------|---|------------|--------|
| 103 | 04.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga M.Gj. | 08.11.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të regjistruar me nr. 4044 prot., datë 04.11.2021, në të cilën kërkonti informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa është në fazën e shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret në lidhje me ankesën tuaj, sipas afateve të parashikuara nga neni 119, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> | Përfunduar | Nuk ka |
| 104 | 16.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga E.A. | 23.11.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, regjistruar me nr. 4129 prot., datë 16.11.2021, në të cilën kërkonti informacion në lidhje me ankesën që keni depozituar pranë institucionit tonë më datë 03.03.202, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), ka marrë në shqyrtim ankesën tuaj.</p> <p>Bazuar në nenin 121 pika 2, shkronja b) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është vendosur verifikimi i ankesës tuaj,</p> | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|--|------------|--|------------|--------|
| | | | | <p>regjistruar me nr. 1604 prot., datë 03.03.2021.</p> <p>Për sa më sipër, lldhur me vendimin që do të merret, do të njoftoheni në vijimësi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.</p> | | |
| 105 | 17.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga K.M. | 23.11.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të regjistruar me nr. 4154 prot., datë 17.11.2021, në të cilën kërkoni informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit fillestar të ankesës tuaj me nr. 3239 prot., datë 21.07.2021, ka konkluduar se ankesa juaj nuk përmbush kriterin për pranueshmëri dhe për këtë arsye bazuar në nenin 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 3239/3 prot., datë 28.10.2021 është vendosur arkivimi i ankesës.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka dërguar në adresën e vendosur nga ana juaj në ankesë, shkresën nr. 3239/4 prot., datë 28.10.2021: “Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës pas shqyrtimit fillestar” dhe një kopje të vendimit. Nga ana e Postës Shqiptare Sh.a. nuk është kthyer zarfi, gjë e cila</p> | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|--|------------|--|------------|--------|
| | | | | tregon se adresa juaj është e saktë. Bashkëlidhur do të gjeni një kopje të vendimit dhe shkresës së sipërcituar. | | |
| 106 | 18.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga T.P. | 26.11.2021 | Ju vëmë në dijeni se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka marrë në shqyrtim ankesën tuaj Nr. 4053. Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa është në fazën e shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit. Përsa më sipër lidhur me vendimin që do të merret do të njoftoheni në vijimësi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. | Përfunduar | Nuk ka |
| 107 | 19.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga A.B. | 26.11.2021 | Në përgjigje të kërkesës tuaj të regjistruar me nr. 3908/2 prot., datë 19.11.2021, në të cilën kërkonte informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se: Inspektori i Lartë i Drejtësisë pas shqyrtimit fillestar të ankesës tuaj me nr. 3239 prot., datë 21.07.2021, ka urdhëruar verifikimin e saj. Pas verifikimit bazuar në nenin 122 pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 2309/9 prot., datë 19.11.2021 është vendosur arkivimi i ankesës. | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|--|------------|--|------------|--------|
| | | | | <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka dërguar në adresën e vendosur nga ana juaj në ankesë, shkresën nr. 2309/9 prot., datë 19.11.2021: “Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas verifikimit të ankesës” dhe një kopje të vendimit. Nga ana e Postës Shqiptare Sh.a. nuk është kthyer zarfi, gjë e cila tregon se adresa juaj është e saktë.</p> <p>Bashkëlidhur do të gjeni një kopje të vendimit dhe shkresës së sipërcituar.</p> | | |
| 108 | 22.11.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesave të paraqitura në ILD-së, nga E.Ç. | 07.12.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 4180 prot., datë 22.11.2021, me anë të së cilës kërkoni informacion mbi ankesat e depozituara nga ana juaj, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat janë në fazën e shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret në lidhje me ankesat, sipas afateve të parashikuara nga neni 119, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|---|------------|---|------------|--------|
| 109 | 07.12.2021 | Kërkesë për informacion se sim und të dërgojë ankesë në ILD e Znj. S.B. | 14.12.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. 4325 prot., datë 07.12.2021, në të cilën kërkon informacion se si ju mund të dërgoni ankesën tuaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, referuar nenit 194 të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për ispektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Mbështetur në parashikimet e nenit 119 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju mund të ngrini pretendimet tuaja, në cilësinë e ankuesit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi shkelje të mundshme disiplinore të kryera nga magjistrati. Ankesa duhet të jetë në formë të</p> | Përfunduar | Nuk ka |
|-----|------------|---|------------|---|------------|--------|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|--|------------|---|------------|--------|
| | | | | <p>shkruar, të përmbushë kriteret e pranueshmërisë dhe mund të paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.</p> <p>Bazuar në urdhrin Nr. 65 datë 28.09.2020 “Për miratimin e modelit të formularit të ankesës”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar modelin e formularit së bashku me udhëzuesin përkatës për plotësimin e tij.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërine maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesa të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik. Për çdo paqartësi dhe për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al, osë të paraqiteni personalisht në ambientet e ILD për asistencën e nevojshme.</p> | | |
| 110 | 23.12.2021 | Kërkesë për informacion mbi një çështje civile e Z. Xh.Ç | 30.12.2021 | <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të regjistruar me nr. 4446 prot., datë 23.12.2021, në të cilën kërkonte informacion në lidhje me çështjen civile me nr. Vendimi 23-2021-1684 (684), datë 09.11.2021, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 194</p> | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|---|------------|--|------------|--------|
| | | | | <p>të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Në këto kushte, referuar dispozitës së sipërpërmendur, objekti i kërkesës suaj është jashtë kompetencës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmëri maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesa të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik. Për subjektet e parashikuara në dispozitën e sipërcituar dhe për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p> | | |
| 111 | 28.12.2021 | Kërkesë për informacion se si mund të dërgojë ankesë në ILD e Z. T.D. | 30.12.2021 | Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. 4472 prot., datë 28.12.2021, në të cilën kërkonte informacion se si ju mund të dërgoni ankesën tuaj, ju vëmë në dijeni se: | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 194 të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Mbështetur në parashikimet e nenit 119 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju mund të ngrini pretendimet tuaja, në cilësinë e ankuesit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi shkelje të mundshme disiplinore të kryera nga magjistrati. Ankesa duhet të jetë në formë të shkruar, të përmbushë kriteret e pranueshmërisë dhe mund të paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.</p> <p>Bazuar në urdhrin Nr. 65 datë</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|-----|------------|---|------------|---|------------|--------|
| | | | | <p>28.09.2020 “Për miratimin e modelit të formularit të ankesës”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar modelin e formularit së bashku me udhëzuesin përkatës për plotësimin e tij, i cili gjendet në rubrikën “Si pranohen ankesat” në kategorinë “Formulari i ankesës” dhe mund të shkarkohet në formatin word për t’u plotësuar me shkrim dore/kompjuter.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmëri maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesa të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik. Për çdo paqartësi dhe për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al, osë të paraqiteni personalisht në ambientet e ILD për asistencën e nevojshme.</p> | | |
| 112 | 21.12.2021 | Kërkesë për informacion e Znj. D.T. ISP | 07.01.2022 | <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rrugë elektronike dhe regjistruar me nr. 4425 prot., datë 21.12.2021, me anë të së cilës keni kërkuar informacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat pika të Rezolutës së Kuvendit janë përmbushur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë | Përfunduar | Nuk ka |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>gjatë vitit 2021?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse ka pika të papërbushura nga Rezoluta e Kuvendit për vitin 2021, cilat janë arsyet e mospërbushjes së tyre nga ILD? - A ka patur raste dhe/ose kërkesa të cilat janë adresuar Kuvendit dhe sa prej tyre janë marrë parasysh? <p>Ju vëmë në dijeni si më poshtë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në respektim të vendimeve nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj” dhe nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, si dhe bazuar në ecurinë e punës së ILD-së që nga dita e fillimit të veprimtarisë së tij, ka bërë një vlerësim të detajuar të të dhënave të depozituara pranë tij nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për periudhën Shkurt-Dhjetor 2020. Në seancën plenare të datë 3 qershor 2021, Kuvendi ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2020 (shkurt-dhjetor)”, përmes së cilës janë lënë disa</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <p>rekomandime.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet ngritjes së një grupi pune, ka marrë mënjëherë masat për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të këtyre rekomandimeve, konkretisht:</p> <p>Rekomandimi nr 1</p> <p>Krijimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e këtij sistemi, si dhe bërjen publik të informacionit të pjesshëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në lidhje me rekomandimin nr. 1, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka caktuar një grup të brendshëm pune, i cili ka punuar në mënyrë intensive më projektin EURALIUS V, në ngritjen dhe vënien në zbatim të sistemit të menaxhimit të çështjeve. Misioni EURALIUS, detyra e të cilit ka përfunduar, ka dorëzuar pranë ILD-së sistemin SMAD. Aktualisht jemi në fazën e dytë, ku bëhet lidhja në rrjetin e brendshëm dhe implementimi i të dhënave në sistem.</p> <p>Nga ana tjetër Zyra e ILD-së ka nisur punën për hartimin e rregullave të</p> | |
|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <p>hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, duke përcaktuar në sistem procese teknike, që të mundësojnë rrjedhën e punës apo qarkullimin e dokumentacionit, afatet përkatëse për trajtim, sipas funksioneve organike të të gjithë përdoruesve..etj.</p> <p>Rekomandimi nr. 2</p> <p>Ngritjen e bazës së të dhënave për ankesat e transferuara nga ish-KLD-ja dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim grupimin e tyre dhe hartimin e një radhe përparësie shqyrtimi.</p> <p>Që në ditët e para të punës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (i krijuar më 1 Shkurt 2020), u ka kërkuar shkresërisht institucioneve që kanë administruar ankesa, sipas kompetencave deri në ngritjen e ILD-së, përcjelljen e fondit të praktikave të ankesave, përkatësisht Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor përcolli pranë Zyrës së ILD-së dy fonde të praktikave, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fondi i parë prej 757 praktika; (praktika/ankesa të cilat janë paraqitur pranë KLGJ gjatë periudhës 2019-2020), dhe • Fondi i dytë, prej 1347 praktika, | |
|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>(praktika/ankesa/fillime hetimi te mbartura nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë) të cilat janë përcjellë pranë Zyrës së ILD-së, me shkresën nr. 862/4 prot., datë 06.07.2020, dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 15/4 prot., datë 28.07.2020.</p> <p>Pas marrjes së fondeve të sipërpërmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me qëllim trajtimin metodologjik dhe jo preferencial të tyre, ka hartuar dhe miratuar 3 urdhra për evidentimin e këtyre praktikave dhe mënyrën e trajtimit të tyre, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Urdhri nr. 66, datë 28.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës, për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare, deri në ngritje të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. 2. Urdhri nr. 98, datë 12.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të | |
|--|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>përcjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Zyres së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë’.</p> <p>3. Urdhri nr. 41, datë 19.02.2021 “Për shpërndarjen e ankesave të mbartura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe të administratuara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.</p> <p>Së fundmi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 131, datë 21.09.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, lidhur me ankesat e trajtuara pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën janar-gusht 2021”.</p> <p>Në zbatim të këtij urdhri, grupi i punës ka nisur nga puna dhe po krijon bazën e të dhënave për ankesat e depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të praktikave të administruara nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me qëllim pasqyrimin e të dhënave të sakta, lidhur më numrin e trajtimit të tyre, objekti, pretendimet e paraqitura në këto ankesa etj.</p> <p>Rekomandimi nr. 3</p> <p>Bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <p>informacioneve me KLGJ-në, KLP-në dhe organet e rivlerësimit kalimtar, që janë përgjegjëse për sistemin e karrierës së magjistratëve lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të depozituara pranë ILD-së për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës.</p> <p>Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka caktuar një person përgjegjës për përcjelljen e informacionit të kërkuar nga KLGJ, KLP dhe KPK, në kuadër të vlerësimit për sistemin e karrierës së magjistratëve lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës.</p> <p>Eshtë një shkëmbim informacioni që përfshin edhe përditësimin numerik e nominal të magjistratëve që vijnë në sistem ose jo.</p> <p>Në çdo rast, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka trajtuar me prioritet maksimal dhënien e informacionit ndaj këtyre institucioneve.</p> <p>Rekomandimi nr. 4 Forcimin e marrëdhënieve</p> | |
|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | <p>institucionale me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorë.</p> <p>Jo thjesht si rekomandim i Kuvendit, por si një nevojë për mbarëvajtjen e punës, forcimi i marrëdhënieve institucionale ka qenë një prioritet i ILD-së, që i është përcjellë si kërkesë Këshillave, që në takimet e para, prej krijimit të institucionit.</p> <p>Prej themelimit më 1 Shkurt 2020, ILD filloi hetimet e para disiplinore ndaj magjistratëve, dhe vetë procesi i punës kërkonte koordinim institucional.</p> <p>Konkretisht, më datë 07.07.2021 në ambientet e Zyrës së ILD-së u organizua një takim i përbashkët, i dakordësuar si nevojë, nga aktorët e përfshirë në procesin e hetimeve dhe procedimeve disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, siç janë KLGJ, KLP dhe ILD.</p> <p>Pikërisht procesi disiplinor, bazuar në legjislacionin e ri të reformës në drejtësi, nxiti krerët e institucioneve të reja, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Artur Metani, kryetaren e KLGJ Naureda Llagami, dhe Kryetarin e KLP Gent Ibrahimit të aktivizojnë këtë platformë komunikimi e koordinimi në një proces sistematik për të identifikuar</p> | |
|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <p>problematikat me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve. Në këto takime kanë përcjellë kontributet e tyre dhe drejtuesit e misioneve ndërkombëtare që asistojnë insitucionet e drejtësisë, misioni i Bashkimit European, EURALIUS dhe misioni i Departamentit të Drejtësisë së SHBA, OPDAT.</p> <p>Rekomandimi nr. 5</p> <p>Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e manualit të hetimit disiplinor, hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe metodologjisë për inspektimin.</p> <p>Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që në momentin e ngritjes dhe funksionimit është përballur me vështirësi përshkak të mungesave në burime njerëzore por edhe në infrastrukture.</p> <p>Gjithsesi përtej vështirësive të hasura në mungesë të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e kompetencave, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përpjekur të ushtrojë çdo kompetencë</p> | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <p>brenda dimensionit ligjor të punës së tij pasi, ka pasur si vizion pune ushtrimin e plotë të komptencave ligjore dhe përgatitjen e infrastrukturës mbështetëse për ushtrimin e këtyre komptencave.</p> <p>Infrastruktura mbështetëse ka përfshirë hartimin e akteve rregullatore, maualeve të punës, trajnimeve të vazhdueshme si dhe marrjen e praktikave më të mira ndërkombëtare nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave.</p> <p>Në këtë kuadër tashmë ka përfunduar dhe është publikuar manuali i hetimit disiplinor, i cili synon të mbështesë interpretimin dhe zbatimin e një kuadri të ri ligjor, mbi sistemin disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët, për të thjeshtuar e përsheptuar punën e inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Gjithashtu është hartuar edhe një draft-rregullore e trajtimit të ankesave, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve dhe Shërbimeve Juridike. Procesi është në fazën e konsultimit dhe dakordësimit të metodës së punës, që ndjekin inspektorët dhe ndihmës inspektorët dhe do të finalizohet me aktin përkatës.</p> <p>Inspektimet tematike (3) që janë në proces po zhvillohen bazuar në metodologjinë e inspektimit të miratuar</p> | |
|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | <p>me aktet përkatëse.</p> <p>Duke qenë se inspektimet tematike janë një dimension i rëndësishëm i punës së ILD-së, po synohet marrja edhe e praktikave më të mira nga institucionet homologe europiane. Kështu ILD ka marrë statusin e anëtarit vëzhgues në Rrjetin European të Shërbimeve të Inspektimit, ku bëjnë pjesë vetëm vendet e BE-së. Përfaqësues të këtij rrjeti (inspektorë magistratë francezë, rumunë dhe italianë) kanë zhvilluar në nëntor 2021 në Tiranë, trajnime të targetuara për inspektimet tematike me inspektorët dhe ndihmës inspektorët duke sjellë praktikën e vendeve të tyre.</p> <p>Bazuar edhe në këto eksperiencia, Zyra e ILD-së po punon për hartimin e metodologjisë mbi inspektimet tematike të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Diskutimi më i fundit u zhvillua më 16 Dhjetor 2021, në një trajnim me temë: “Praktika Europiane dhe Parime të Përgjithshme rreth Inspektimeve Institucionale dhe Tematike: çështje të vlerësimit të performancës së gjyqësorit”, ku morën pjesë të gjitha strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Kjo masë është planifikuar për t’u trajtuar me prioritet edhe përgjatë vitit 2022.</p> <p>Rekomandimi nr. 6</p> | |
|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | <p>Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2020 ka vijuar punën me një inspektor të vetëm, dhe ka kërkuar në vazhdimësi komandimin e magjistratëve të tjerë pranë Këshillave.</p> <p>Nga ana e KLGJ-së u realizuan 6 (gjashtë) shpallje, për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së ILD-së, por nuk pati asnjë aplikim dhe për rrjedhojë asnjë magjistrat gjyqtar nuk u komandua.</p> <p>Duke vlerësuar rëndësinë primare të këtij procesi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë më datë 2 dhjetor 2020 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me propozime për ndryshime në dy ligje, përkatësisht ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar. Këto propozime janë vlerësuar të nevojshme për garantimin e funksionimit normal të Institucionit dhe plotësimin të vakancave të krijuara për pozicionet inspektorë magjistratë dhe inspektorë jomagjistratë. Deri më tani, nuk ka një</p> | |
|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <p>përgjigje zyrtare në lidhje me këto propozime.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë, më datë 8 shkurt 2021 ka komanduar 4 magjistratë prokurorë, për një periudhë 5 vjeçare, pranë Zyrës së ILD-së.</p> <p>Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në shkurt 2021, në përfundim të procedurave ligjore ka emëruar 4 inspektorë jomagjistratë. Pra, nga muaji shkurt 2020 deri më datë 7 shkurt 2021, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka funksionuar vetëm me një inspektor magjistrat. Prej datës 8 shkurt dhe në vijim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ushtrojnë detyrën 8 inspektorë nga 26 inspektorë të miratuar me Vendimin nr. 28/2020 i ndryshuar “Për miratimin e structures organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.</p> <p>Me shkresën nr. 37/6 prot., datë 29.09.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i është kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, rishpallja e procedurave për kandidimin e 6 (gjashtë) magjistratëve gjyqtarë për pozicionin inspektorë pranë ILD-së, dhe deri më sot nuk është komanduar asnjë magjistrat gjyqtar.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më datë 30 Shtator 2021, ka</p> | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | <p>shpallur thirrjen e 9 (nëntë) pozicioneve për inspektorë jomagjistratë pranë njësisë së inspektorëve, pas së cilës janë paraqitur disa kandidatura të cilat janë në proces verifikimi dhe vlerësimi.</p> <p>Rekomandimi nr. 7</p> <p>Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Për këtë qëllim Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 2361/1 prot, datë 12.05.2021, ka kërkuar paraqitjen e tematikave apo çështjeve, të cilat mund t'i nënshtrohen inspektimit tematik apo institucional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.</p> <p>Në përgjigje të shkresës nr. 2361/1 prot, datë 12.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 783/1 prot, datë 24.05.2021 ka propozuar ndër të tjera nevojën për zhvillimin e një inspektimi tematik me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën</p> | |
|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.”</p> <p>Në vijim të kërkesave tona, por edhe përgjigjeve të marra, janë diskutuar tematikat e ndryshme, por edhe janë analizuar faktorët realë të zbatimit të ligjit, andaj edhe është organizuar një takim punë dy ditor, ku është diskutuar ndërmjet Inspektori të Lartë të drejtësisë, njësive drejtpërdrejt të angazhuara me inspektimet dhe me aktorë ndërkombëtarë, fillimi i punës për të hartuar planin vjetor të inspektimeve.</p> <p>Pavarësisht numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe numrit të lartë të ankesave të mbartura, deri tani ILD ka nisur 3 (tre) inspektime tematike, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në funksion të prioritetit të shpallur publikisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që në marrje të detyrës për trajtimin e kërkesavë “Lirim me kusht” të personave të dënuar me burgim të përjetshëm, ka nisur inspektimi i parë tematik bazuar në vendimin Nr.1, datë 11.02.2020 “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirimi me kusht”.</p> <p>2. Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” i ndryshuar.</p> <p>3. Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.</p> <p>Rekomandimi nr. 8 Promovimin dhe rritjen e ndërveprimit</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|--|
| | | | | <p>të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët nëpërmjet aktiviteteve, informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes duke përdorur çdo kanal tjetër të komunikimit publik.</p> <p>Marrëdhënia me publikun është cilësuar si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e publikut tek ILD në veçanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi.</p> <p>Në zbatim të këtij vizioni dhe strategjisë së komunikimit e transparencës së ILD-së me publikun, si dhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit në lidhje me rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët, është punuar në disa drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ristrukturimi i faqes zyrtare të web-it: www.ild.al. Është krijuar një dizajn i ri për të krijuar lehtësi në hulumtimin e çdo vizitori në faqe dhe për të kërkuar informacionin në kohë reale. Faqja ekziston në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe informacioni përditësohet sistematikisht në të dy gjuhët, për t'i ofruar më tepër akses dhe lehtësi vizitorëve shqipfolës apo të huaj të faqes. | | |
|--|--|--|--|---|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>2. Mes publikimeve informuese dhe edukuese për qytetarët mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përgatitur dhe publikuar në faqe dhe në kanalin Youtube një material audiovizual 85 sekondësh prezantues i institucionit, detyrave dhe procesit të ankimimit ndaj magjistratëve.</p> <p>3. Për të orientuar dhe lehtësuar procesin e ankimimit të qytetarëve ndaj magjistratëve në faqen e ILD, në zonën më të dukshme, ka një rubrikë të posaçme “Si pranohen ankesat”, ku shpjegohen etapat e paraqitjes së një ankese, formulari përkatës, si dhe jepen shembuj konkretë me problematika, që e sqarojnë në mënyrë shteruese këtë procedurë. Për të ilustruar më tej këtë proces është konceptuar dhe hartuar e ankesës, në sistemin dygjuhësh, e cila pasqyron të gjitha fazat që ndjek ankesa, që prej depozitimit pranë ILD-së</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | | | | <p>deri në përfundim të trajtimit të saj. Kjo hartë është paraqitur në mënyrë grafike, e thjeshtuar, për të qenë e aksesueshme nga çdo grupmoshë.</p> <ol style="list-style-type: none">4. Qytetarët që duan të kryejnë fizikisht procesin e ankimimit në ILD, asistohen sipas nevojës nga Sektori i Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, që i pret dhe ndihmon në plotësimin e formularit TIP të ankesës cdo ditë të javës nga ora 09.00-14.00.5. Adresa zyrtare e e-mailit info@ild.al shërben si mjet tjetër komunikimi për dërgimin e ankesave, por jo vetëm kaq. Me anë të postës elektronike qytetarët mund të marrin çdo informacion që i nevojitet dhe të dërgojnë çdo dokumentacion të nevojshëm për të lehtësuar komunikimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.6. Për një mënyrë më shumë e më të shpejtë komunikimi, është vënë në dispozicion numri | |
|--|--|--|--|---|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>zyrtar i telefonit, ku qytetarët mund të kontaktojnë, në përputhje edhe me të drejtën e tyre të informimit.</p> <p>7. Në faqen zyrtare të ILD jepen dhe përditësohen çdo javë shifrat e punës javore në institucion, lidhur me ankesat e konfirmuara, ankesat e trajtuara, ankesat në proces trajtimi, ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, vendime për fillim hetimi disiplinor dhe kërkesa për procedim disiplinor. Shifrat freskohen cdo ditë të hëne.</p> <p>8. Një përmbledhje mbi ecurinë mujore të punës, edhe në shifra, pasqyrohet në Buletinin mujor, që publikohet në shqip dhe anglisht, po në faqen zyrtare të ILD-së, në ditën e parë të çdo muaji.</p> <p>9. Komunikimi me publikun realizohet edhe përmes llogarisë zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Twitter.</p> <p>10. Për një komunikim më dinamik shërben edhe kanali zyrtar</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | <p>Youtube, në të cilin pasqyrohet çdo aktivitet mediatik i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me video.</p> <p>11. Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, i cili ushtron të gjitha detyrimet dhe të drejtat sipas ligjit të sipërcituar.</p> <p>Për sa më sipër, rezulton se nga 8 rekomandimet e vendosura sipas Rezolutës së Kuvendit të RSH, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 4 prej tyre janë përmbushur (rekomandimet nr. 2, 3, 4 dhe 8), • 4 rekomandimet e tjera janë në proces (rekomandimet 1, 5, 6 dhe 7); <p>Sa i përket kërkesës suaj për informacion “ A ka patur raste dhe/ose kërkesa të cilat janë adresuar Kuvendit dhe sa prej tyre janë marrë parasysht”, ju vëmë në dijeni se gjatë vitit 2021, nuk kemi paraqitur kërkesa drejtuar</p> | |
|--|--|--|--|--|--|

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| | | | | Kuvendit të R.SH. | | |
|-----|------------|---|------------|---|------------|--------|
| 113 | 28.12.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesave së paraqitur në ILD-së, nga A.K. | 11.01.2022 | <p>Ju vëmë në dijeni se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj nr. 3198/2 prot., datë 28.12.2021.</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat nr. 1944/3 prot., datë 08.03.2021, nr. 1944/2 prot., datë 06.10.2020 dhe nr. 1944 prot., datë 28.08.2020 janë në fazën e shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit.</p> <p>Përsa më sipër lidhur me vendimin që do të merret do të njoftoheni në vijimësi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.</p> | Përfunduar | Nuk ka |
| 114 | 30.12.2021 | Kërkesë për informacion lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur në ILD nga K.M. | 10.01.2022 | <p>Ju vëmë në dijeni se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka marrë në shqyrtim ankesën tuaj.</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa është në fazën e shqyrtimit fillestar dhe vlerësimit.</p> <p>Përsa më sipër lidhur me vendimin që do të merret do të njoftoheni në vijimësi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.</p> | Përfunduar | Nuk ka |